



Vlerësim i Ndikimit në Mjedis, Social dhe në Shëndet (VNMSSH) për Vrojtim sizmik 2D në Bllokun 4, me linja të zgjatura në Blloqet 2-3, në tokë, Shqipëri

Përmbledhje Jo-teknike



Përmbajtja

1.	Vështrim i përgjithshëm	4
2.	Hyrje	5
3.	Përshkrimi i projektit.....	7
4.	Procesi i VNSSH-së.....	10
5.	Përfshirja e Palëve të Interesit	12
6.	Gjendja ekzistuese e mjedisit	13
7.	Vlerësimi i ndikimit dhe Masat zbutëse	17
	Ndikimet në mjedisin biofizik.....	19
	Ndikimet nga shkarkimet në mjedis të projektit.....	21
	Ndikimet sociale, ekonomike dhe në trashëgiminë kulturore	22
8.	Ngjarjet e paplanifikuara	25
9.	Ndikimet kumulative.....	25
10.	Ndikimet pozitive.....	25
11.	Menaxhimi dhe Monitorimi i Mjedisit	26
12.	Përfundime	26

1. Vështrim i përgjithshëm

Shell Upstream Albania B.V. (këtu e më poshtë referuar si SUA) po planifikon të zhvillojë gjatë vitit 2019 një vrotim sizmik 2D (këtu e më poshtë referuar si "Projekti") në Bllokun 4, me linja të zgjatura në Blloqet 2-3, në pjesën jugore të Shqipërisë. Me qëllim që të menaxhohen ndikimet e projektit dhe të plotësohen kërkesat e liçencimit, është kryer Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, Social dhe në Shëndet (VNMSSH) i cili përshkruan kërkesat rregullatore dhe kushtet e mjedisit fizik, biologjik e social të zonës së projektit. VNMSSH identifikon receptorët potencialë që mund të ndikohen nga aktivitetet e projektit të propozuar, vlerëson ndikimet dhe përshkruan masat zbutëse që ndihmojnë menaxhimin e ndikimeve të operacioneve të vrotimit sizmik të propozuar. Kjo Përmbledhje Jo-teknike është një përmbledhje e raportit VNMSSH e cila përshkruan çështjet kryesore të kapitujve të tij. Për të kuptuar më mirë aktivitetet, ndjeshmëritë, ndikimet e mundshme, rëndësinë e tyre si dhe masat zbutëse dhe menaxhuese, lexuesi këshillohet t'i referohet draftit final të VNMSSH-së.

Vrotimi sizmik i propozuar do të përdorë një metodë standarte të përvetësimit të informacionit sizmik duke përdorur eksplozivë ose makina speciale vibruese përgjatë afërsisht 212 km linjave sizmike. Vrotimi do të zhvillohet në një mjedis ekologjik e social të pasur përfshirë veçoritë e biodiversitetit, zona të mbrojtura, trashëgiminë kulturore, burimet ujore dhe komunitetet lokale. Zonat e mbrojtura janë zona të caktuara që mbrohen nga legjislacioni shqiptar ose janë ndërkombëtarisht të njohura, pa status kombëtar mbrojtës. Këto zona përfshijnë si monumente natyre (me karakteristika biologjike ose gjeologjike të veçanta) ashtu edhe monumente të trashëgimisë kulturore.

Për të përcaktuar pasojat e përgjithshme të ndikimit, vlerësimi i tij ka marrë në konsideratë ndjeshmërinë (rëndësinë/cënueshmërinë) e receptorëve përkundrejt shkallës së ndryshimit të mundshëm të tyre si rezultat i aktiviteteve të projektit. Nëpërmjet kësaj qasjeje, është vlerësuar rëndësia e ndikimeve mbetëse për çdo receptor të identifikuar. Ky proces merr parasysh ndjeshmërinë e receptorit, shkallën e ndryshimit dhe masat zbutëse që do të zbatohen, që lenë një ndikim mbetës.

Përdorimi i eksplozivëve do të kryhet nën sipërfaqen e tokës (në thellësi deri në 12 m), i shtrirë gjatë tre muajve, nën një regjim operacional shumë të kontrolluar dhe do të bëhet nga një kontraktor me eksperiencë. Vrotimi do të kryhet në vijueshmëri; aktivitetet e vrotimit do të zhvillohen në një zonë të caktuar dhe vetëm pasi të kenë përfunduar do të zhvendosen në një zonë tjetër. Për rrjedhojë koha e operacioneve në një zonë do të jetë e kufizuar.

Fleksibiliteti i përcaktimit të pozicionit të linjës sizmike brenda një korridorit prej 500 m do të ndihmojë në shmangien dhe/ose minimizimin e prerjes së vegjetacionit, duke zvogëluar ndikimet në ekologjinë e zonës. Gjurma faktike e linjës sizmike brenda korridorit do të jetë jo më shumë se 5 m. Përveç kësaj, do të aplikohet një zonë buferike prej 200 m për të shmangur më tej receptorët e ndjeshëm të tillë si monumentet kulturore të caktuara. Përdorimi i makinerive të rënda dhe automjeteve propozohet të kryhet në rrugët ekzistuese dhe nën protokolle të rrepta të Shëndetit dhe Sigurisë. Uji i nevojshëm për projektin do të sigurohet nga furnitorë lokalë të zgjedhur me kujdes dhe nën regjim monitorimi. Burimet e energjisë sizmike mund të shkaktojnë dëmtive të pejzazhit karstik të ndjeshëm. Ky rrezik është identifikuar dhe janë propozuar masa zbutëse. Për të minimizuar mundësinë e rreziqeve mbetës, veç masave kontrolluese ekzistuese brenda projektit teknik do të zbatohen edhe masa shtesë.

Ndikimet kryesore sociale dhe në shëndet të lidhura me shtrirjen hapsinore të aktiviteteve të projektit, veçanërisht ato që përfshijnë fuqinë punëtore nga jashtë zonës së projektit, lidhen me hyrjen dhe përdorimin e tokës, akomodimin e fuqisë punëtore në fshatra dhe dëmtimet e mundshme të ndërtesave nga vrotimi sizmik. Përveç këtyre, janë konsideruar mbishfrytëzimi i burimeve ujore dhe shërbimeve mjekësore të komunitetit si dhe shqetësimi i krijuar nga fuqia punëtore e projektit ose trafiku. Janë propozuar Praktikata e Mira Ndërkombëtare të Industrisë si dhe qasjet lokale të provura të cilat përfshijnë teknikat e shmangies, kompensimin, angazhimin dhe konsultimin efektiv dhe zbatimin e kodit të sjelljes së mirë. Projekti parashikohet të ndikojë pozitivisht nëpërmjet punësimit gjatë kohëzgjatjes së operacioneve dhe blerjes së mallrave dhe shërbimeve nga njësitë tregtare lokale/rajonale.

Një strategji kyç për zbatimin e masave zbutëse dhe kontrolluese për minimizimin e ndikimeve është zbatimi i një kuadri të strukturuar të menaxhimit dhe monitorimit. SUA dhe kontraktori i saj i sizmikës do të hartojnë dhe zbatojnë plane menaxhimi me objekte të caktuara (si p.sh. Plani i Sigurisë së Transportit Tokësor) me qëllim pajtueshmërinë dhe menaxhimin e ndikimeve.

Nëpërmjet zbatimit të suksesshëm të masave zbutëse/kontrolluese dhe planeve të mirëpërcaktuara dhe koordinuar të menaxhimit, ndikimet mbetëse nga aktivitetet e vrotimit sizmik të propozuar me shumë gjasa do të jenë pak të rëndësishme ose të parëndësishme.

2. Hyrje

Shell Upstream Albania B.V. (këtu e më poshtë referuar si SUA) është operatori i Kontratës me Ndarje Prodhimi (KNP) për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e hidrokarbureve në Blloqet 2 - 3 në tokë, Shqipëri, ku aktualisht po kryen aktivitete vlerësimi. SUA ka nënshkruar një Kontratë me Ndarje Prodhimi (KNP) për Kërkimin, Zhvillimin dhe Prodhimin e hidrokarbureve në Bllokun 4, miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr.350 datë 12.06.2018. SUA propozon zhvillimin gjatë vitit 2019 të një vrojtimi sizmik 2D (këtu e më poshtë referuar si "Projekti") në Bllokun 4, me linja të zgjatura në Blloqet 2-3. Vrojtimi i propozuar do t'i mundësojë SUA-s vlerësimin e potencialit të hidrokarbureve në Bllokun 4 dhe do të ndihmojë në identifikimin e zonave të mundshme për aktivitete të ardhme potenciale të shpimit kërkimor.

Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis, Social dhe në Shëndet (VNMSH) është përgatitur në përputhje me legjislacionin shqiptar, standartet e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (KFN) dhe Shell-it, të cilët kërkojnë që projektet me ndikime të mundshme në mjedis, të kryejnë Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Social dhe në Shëndet (VNMSH). VNMSH (referuar si Vlerësim i Ndikimit në Mjedis (VNM) në Shqipëri) është përgatitur përpara fillimit të zbatimit të projektit. VNMSH është në përputhje me kërkesat e autoriteteve rregulatore shqiptare dhe i përgjigjet komenteve dhe sugjerimeve të marra gjatë fazës së parë të përfshirjes dhe takimeve me palët e interesit.


VNMSH është përgatitur nga një ekip specialistësh të drejtuar nga AECOM, një konsulent inxhinierik dhe mjedisor global, i cili operon në më shumë se 150 vende të botës, mbështetur nga EMA Consulting, një kompani konsulencash mjedisore me qendër në Shqipëri. EMA ka një eksperiencë të gjerë në kryerjen e VNM-ve kombëtare dhe procesin e përfshirjes së palëve të interesit për degë të ndryshme të industrisë përfshirë sektorin e naftës dhe gazit.

Blloku 4 shtrihet në pjesën jugore të Shqipërisë, në jug të Blloqeve 2-3 dhe afër kufirit me Greqinë, afërsisht 100 deri 200 km në jug të Tiranës. Zona e projektit përfshihet në 4 qarqe - Berati, Korça, Gjirokastra dhe Vlora, megjithatë vrojtimi sizmik do të kryhet në qarkun e Gjirokastrës. Figura 1 paraqet vendodhjen e zonës së projektit dhe korridoreve/gjurmëve të parashikuara sizmike brenda të cilave do të kryhet vrojtimi.

Zona e projektit përfshin monumente natyre të mbrojtura dhe të trashëgimisë kulturore. Zonat e mbrojtura janë zona të caktuara që mbrohen nga legjislacioni shqiptar ose janë ndërkombëtarisht të njohura, pa status kombëtar mbrojtës. Disa nga zonat e mbrojtura në nivel kombëtar janë gjithashtu të njohura ndërkombëtarisht. Zonat e mbrojtura e marrin këtë status për shkak të vlerave të tyre natyrore, ekologjike ose kulturore.

Pozicioni përfundimtar e linjave sizmike brenda korridoreve sizmike do të bazohet në veçoritë e terrenit, mundësisë për akses dhe afërsisë me receptorët e ndjeshëm si fshatrat, monumentet e kulturës, monumentet e natyrës dhe habitateve ekologjike të ndjeshëm.

Figura 1: Vendodhja e zonës së vrojtimit sizmik




3. Përshkrimi i projektit

Vrojtimi sismik është një metodë për hulumtimin e strukturave gjeologjike dhe potencialit të tyre për zbulimin e naftës, gazit natyror dhe shtresave minerare. Fushata e vrotimit sismik 2D propozuar nga SUA përfshin rreth 212 km linja (në kuptimin hapsinor, jo fizik) dhe pritet të nisë në tremujorin e dytë (T2) të vitit 2019, pas marrjes së të gjitha aprovimeve dhe lejeve përkatëse, dhe mund të zgjasë deri në 6 muaj.

Vrojtimit sismike përdorin eksplozivë ose makina të specializuara (vibruese). Valët zanore reflektohen nga formacionet shkëmbore të nëntokës dhe kapen në sipërfaqe nga sensorë (paisje) regjistruar. Sensorët janë të lidhur me një makinë qendrore regjistrimi (shih Figurën 2).


Figura 2 Paraqitje skematike e vrotimit sismik



Zgjedhja e burimit të energjisë (eksplozivë apo makina të specializuara vibruese) do të varet nga terreni, mundësitë për akses, thellësia e shtresës gjeologjike dhe parametra të tjerë operacionale.

Aktivitetet e vrotimit sismik do të zhvillohen brenda një korridorit prej 500 m përgjatë linjës. Kjo do të sigurojë fleksibilitet të mjaftueshëm për shmangien e receptorëve të ndjeshëm mjedisorë dhe socialë ndërkohë që lejon të përftohen të dhëna të besueshme sismike. Janë përcaktuar dhe miratuar zonat buferike në të cilat nuk do të zhvillohen aktivitete të vrotimit sismik ose ato do të jenë të kufizuara. Për këto zona buferike janë marrë parasysh legjislacioni shqiptar dhe udhëzimet përkatëse. Gjurma faktike e linjës sismike brenda korridorit prej 500 m, në të cilën do të zhvillohen aktivitete sismike, do të jetë afërsisht 5 m. Kjo gjerësi do të mjaftojë për të lejuar lëvizjen e automjeteve dhe shmangien e objekteve (p.sh. struktura, pemë, pellgje apo shkëmbinj). Në disa zona, aktivitetet e vrotimit do të kufizohen vetëm në vendosjen e gjeofonëve; këto zona përkohë me fundet e linjave sismike. Duke marrë parasysh legjislacionin shqiptar i cili përcakton krijimin e një zone mbrojtjeje për vende të caktuara si monumente kulturore, është miratuar një zonë buferike prej 200 m. SUA do ta aplikojë këtë lloj mbrojtjeje edhe për receptorë të tjerë të ndjeshëm, kur është e përshtatshme. Aktivitetet brenda kësaj zone do të ndryshojnë në varësi të ndjeshmërisë.

Kuadrati 1 më poshtë paraqet në mënyrë të përmblëdhur aktivitetet e ndryshme sipas secilës metodë. Disa nga aktivitetet janë të veçanta për metodën përkatëse të vrotimit sismik ndërsa të tjerat zhvillohen pavarësisht metodës së zgjedhur të vrotimit.



Mobilizimi do të fillojë pas marrjes së Deklaratës Mjedisore dhe lejeve të tjera përkatëse. Mobilizimi do të përfshijë lëvizjen e ekipeve dhe paisjeve për në zonën e projektit si dhe, ngritjen e objekteve mbështetëse (bazës, kampeve fushorë, bazës së helikopterëve dhe magazinës së eksplozivëve). Termi “marrja e lejes” në vërtetimin sismik përdoret për të përshkruar procesin e dakordësimit dhe marrjes së lejes nga pronarët e tokave për hyrjen në tokat e tyre dhe kompensimin për hyrjen ose dëmtime të mundshme (p.sh. struktura, kultura bujqësore etj.). Përpara fillimit të vërtimit, një ekip do të kryejë rikonjicionin e zonës për identifikimin përgjatë korridoreve sismikë të tipareve kryesore me ndjeshmëri natyrore (ekologjike, gjeologjike, hidrologjike) ose kulturore. Ekipi do të punojë me specialistë të cilët do të identifikojnë këto zona të ndjeshme. Ekipi gjithashtu do të dokumentojë afërsinë e linjave sismike me zonat e banuara dhe objekte të infrastrukturës (p.sh. ura, rrugë, shtigje) si dhe do të hartojë planet logjistike për lëvizjen e ekipit dhe paisjeve në zonën e vërtimit

Për të dyja metodat, në disa zona mund të nevojitet pastrimi i vegjetacionit për të lejuar që ekipi i vërtimit të ketë një pamje të qartë dhe për të krijuar akses të mjaftueshëm për automjetet dhe personelin që do të vendosë dhe do të largojë paisjet e kërkimit sismik. Hyrja në korridoret sismikë dhe vendosja e marrësve në disa raste mund të kërkojë prerjen e bimësisë (p.sh. shkurre të dendura). Pastrimi i vegjetacionit brenda korridorit sismik do të varet nga lloji i bimësisë që gjendet aty dhe automjeteve që do të përdoren për aksesin. Do të mbahet një minimum absolut i gjerësisë, aq sa për të lejuar ecjen dhe vendosjen e paisjeve të vërtimit

Do të shpohen rreth 3,000 puse plasjesh në të cilët do të vendoset ngarkesë eksplozive (1 deri në 4 kg) jo toksike dhe që shpërbëhet. Pusët me diametër 9 cm do të shpohen në thellësi 10-20 m dhe nëse është e nevojshme vrimat e puseve do të çimentohen në mënyrë që të garantohet qëndrueshmëria e tyre. Faza e shpimit do të fillojë sapo një ose disa linja të jenë vërtuar dhe do të zgjasë afërsisht 3 muaj. Ekipet e shpimit priten të kenë afërsisht 4 vetë secili. Pritet të jenë 10 deri në 20 ekipe shpimi të cilët do të veprojnë njëkohësisht (në varësi të përdorimit të metodës me dridhje e cila mund të zëvendësojnë përdorimin e ngarkesave të groposura). Secili ekip shpimi do të ketë sondën e tij të shpimit dhe një automjet transporti.

Përdorimi i autosondave do të jetë i kufizuar për shkak të terrenit malor. Këto zona do të vlerësohen për shpimin e puseve të plasjeve me sonda shpimi të lëvizshme të transportuara nga personeli (me krahë) ose me helikopter (Helisonda). Më poshtë janë treguar shembuj të sondave të montuara në traktor dhe sondave të transportuara me helikopter (helisonda), përkatësisht Figura 3 dhe Figura 4.

Figura 3 Sondë shpimi e montuar në traktor



Figura 4 Sondë porative që transportohet me helikopter (helisondë)



Metoda me dridhje (vibrime) e regjistrimit të të dhënave sizmike përdor një automjet vibrues i cili shkakton dridhje të tokës përmes vendosjes mbi sipërfaqe të platformës vibruese e cila kryen vibrimet. Kjo metodë mund të përdoret atje ku vendosja e eksplozivëve është e vështirë ose kushtet mjedisore ose të sigurisë nuk janë të përshtatshme për përdorimin e tyre. Gjithsesi kamionët vibrues mund të jenë të përmasave shumë të mëdha dhe operimi i tyre kërkon mundësi shumë të mira aksesit në zonë. Shembull i një kamioni vibrues është treguar në Figura 5.

Figura 5 Kamion vibrues



Përpara fillimit të operacioneve të regjistrimit përgjatë secilës linjë sizmike, gjeodetët do të përcaktojnë distancën minimale standarte të zhvendosjes së zonës së operacioneve për të shmangur ndikimet në infrastrukturën ekzistuese ose zonat e mbrojtura (të tilla si ndërtesa, monumente natyrore, objekte të trashëgimisë kulturore, habitate të ndjeshëm dhe burime ujore). Nëse një pikë vrojtimi bie brenda kufirit të distancës së sigurisë nga operacionet, atëherë gjeodeti do ta zhvendosë atë.

Pasi vendosen gjeofonët, realizohet gjenerimi i dridhjeve si rezultat i çlirimit të energjisë sizmike nëpërmjet shpërthimit të eksplozivëve ose duke përdorur kamionët vibrues. Pas çlirimit të energjisë sizmike, gjeofonët hiqen dhe vijohet me vlerësimin e zones dhe më tej, nëse është e nevojshme, me rikthimin e saj në gjendjen e mëparshme.

Programi i vrojtimit sizmik 2D është parashikuar të fillojë në tremujorin e dytë të 2019. Gjithsesi programi mund të zgjatet edhe në 2020 për shkak të kufizimeve operacionale. Parashikohet që programi të zgjasë 6 muaj, periudhë në të cilën operacionet kryesore zhvillohen paralelisht. Operacionet do të përparojnë në mënyrë të vazhdueshme, duke lëvizur zonë pas zone dhe nuk do të zhvillohen të shpërndara përgjatë 212 km të linjave sizmike njëkohësisht. Kohëzgjatja e parashikuar e projektit tregohet në Tabela 1.


Tabela 1 Kohëzgjatja e parashikuar e projektit

Operacionet kryesore	Kohëzgjatja e vlerësuar
Mobilizimi, Rikonjicioni, Planifikimi & Marrja e lejeve	3-4 javë
Shpimi i puseve të plasjeve	3 muaj
Shtrirja e kablllove/gjeofonëve & Regjistrimi	3 muaj
Largimi i paisjeve dhe ekipit nga linjat	1 muaj
Pastrimi pas përfundimit të vrojtimit dhe rehabilitimi	2 muaj

4. Procesi i VNMSSH-së

Procesi i VNMSSH përfaqëson një qasje sistematike për parashikimin dhe vlerësimin e ndikimeve të mundshme në mjedis, sociale dhe në shëndet të një projekti të propozuar, duke vlerësuar alternativat dhe hartuar masat e nevojshme zbutëse, menaxhuese dhe monitoruese. Rezultatet e kësaj VNMSSH-je, përveçse do të ndihmojnë propozuesin e projektit të menaxhojë ndikimet e projektit, do t'i mundësojnë MTM, Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe agjencive të tjera qeveritare të vendosin për zhvillimin e propozuar bazuar në informacion dhe do të lejojë pjesëmarrjen në proces të palëve të interesit potencialisht të ndikuara. Procesi hap pas hapi tregohet në Figura 6.

Figura 6 Procesi i VNMSSH-së



Janë studiuar dhe dokumentuar kushtet bazë të mjedisit në mënyrë që ndryshimet ose ndikimet e mundshme të projektit të vlerësohen kundrejt tyre. Kushtet bazë të mjedisit nënkuptojnë karakteristikat fizike, biologjike, socio-ekonomike dhe të trashëgimisë kulturore, që ekzistojnë në zonën e aktiviteteve të projektit përpara fillimit të zbatimit të tij. Ndikimet janë identifikuar dhe vlerësuar bazuar në aktivitetet e ndryshme të projektit (mobilizimi, ngritja dhe operimi i objekteve mbështetës, vrojtimi sizmik, çmobilizimi dhe rehabilitimi).

Ndikimi i mundshëm është vlerësuar për të përcaktuar rëndësinë e tij, e cila është një indikator që tregon sa domethënës ose me pasoja është një ndikim. Rëndësia e ndikimit merr parasysh madhësinë e ndikimit dhe ndjeshmërinë e receptorëve të ndikuar (p.sh. trup ujqor, ajër, ngastër toke, komunitet, habitat ose organizëm individual, njeri ose pronë që mund të jenë subjekt i një ndikimi). Madhësia e një ndikimi tregon shkallën e ndryshimit të kushteve bazë të mjedisit. Një receptor i caktuar mund të jetë pak ose shumë i ndjeshëm ndaj një ndikimi të dhënë. Disa receptorë mund të ndryshojnë në një shkallë më të madhe, ose kanë më pak mundësi për menaxhimin e ndryshimeve krahasuar me receptorë të tjerë të cilët mund të përshtaten më lehtë ndaj një ndryshimi.

Rëndësia e ndikimit është vlerësuar duke marrë parasysh masat kontrolluese (të quajtura masa zbutëse të propozuara) ekzistuese (të përcaktuara në projektin teknik). Masat që përfshihen në projektin teknik për shmangien dhe kufizimin e ndikimeve ndihmojnë në mbrojtjen e receptorëve të ndjeshëm mjedisorë e socialë ndërsa masat e kontrollit të tilla si p.sh. vendosja e një ene për mbledhjen e vajrave poshtë paisjeve që kullojnë, ndihmojnë në kontrollin e përhapjes së ndotjes.

Kombinimi i madhësisë së efektit dhe ndjeshmërisë së receptorit përcaktojnë shkallën e ndikimit. Ndikimet e vlerësuar si *të lartë* ose *të mesëm* konsiderohen si *të rëndësishëm*. Një ndikim që parashikohet *i ulët* ose *i papërfillshëm* konsiderohet i menaxhueshëm ose *i parëndësishëm*.

Matrica e rëndësisë së ndikimit

		Ndjeshmëria e receptorit (cënueshmëria dhe vlera)			
		E papërfillshme	E ulët	Mesatare	E lartë
Madhësia/Shkalla e ndikimit (shtrirja, shpeshësia, mundësia e kthimit, kohëzgjatja)	E papërfillshme	E parëndësishme	E parëndësishme	E parëndësishme	E parëndësishme / E ulët*
	E ulët	E parëndësishme	E ulët	E ulët / Mesatare*	Mesatare
	Mesatare	E parëndësishme	E ulët / Mesatare*	Mesatare	E lartë
	E lartë	E parëndësishme / E ulët*	Mesatare	E lartë	E lartë

Pas identifikimit të ndikimeve të mundshme është kryer një vlerësim paraprak i rëndësisë së ndikimeve. Pas kësaj janë zhvilluar strategjitë për shmangien ose zbutjen e ndikimeve. Më tej, është rivlerësuar rëndësia e ndikimeve duke marrë parasysh zbatimin e këtyre masave zbutëse. Ndikimi përfundimtar është ai që njihet si “ndikimi mbetës” dhe përfaqëson ndikimin i cili do të mbetet edhe pas zbatimit të masave zbutëse dhe menaxhuese, e për rrjedhojë është niveli i fundit i ndikimit që lidhet me projektin.

5. Përfshirja e Palëve të Interesit

Një komponent i rëndësishëm i procesit të VNMSSH është tërheqja e mendimeve/qëndrimeve, opinioneve dhe shqetësimeve të palëve të ndryshme të interesit përfshirë, përfaqësues të komuniteteve lokale, grupe interesi, organizata jo qeveritare, agjenci shtetërore dhe çdo palë tjetër të interesuar ndaj aktiviteteve të propozuara sizmike. Procesi i përfshirjes së Palëve të Interesit zhvillohet gjatë gjithë procesit të VNMSSH si dhe gjatë zbatimit të projektit. Ekipi i VNMSSH-së ka përgatitur një Plan të Përfshirjes së Palëve të Interesit (PPPI) i cili përcakton procesin e angazhimit dhe konsultimit të palëve të interesit gjatë VNMSSH-së. Një përmbledhje e palëve kryesore të interesit të konsultuara gjatë VNMSSH është treguar në kuadratin 2 më poshtë.

Kuadrati 2

Përmbledhje e Palëve të Interesit

Autoritete Kombëtare

- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM)
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM)
- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM)

Përfaqësues të qarkut Gjirokastrë

- Prefekti i qarkut
- Drejtoria Rajonale e Mjedisit
- Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore

Autoritetet e Bashkive

- Dropull
- Gjirokastrë
- Këlcyrë
- Libohovë
- Memaliaj
- Përmet
- Tepelenë

Përfaqësues të Njësive Administrative

- Antigone
- Cepo
- Dishnicë
- Luftinjë
- Lunxhëri
- Memaliaj Fshat
- Përmet
- Petran
- Picar
- Qendër Piskovë
- Qendër Tepelenë
- Zagorie

Autoritetet Rajonale

- Drejtoria Rajonale e Mjedisit
- Administrata Rajonale e Zonave të Mbrojtura
- Inspektoriat i Mjedisit dhe Pyjeve
- Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore
- Drejtoria Rajonale e Rrugëve
- Drejtoria rajonale e Transportit

Ndërmarrjet e Ujësullës ose Departamentet përkatës në bashkitë

- Dropull
- Gjirokastrë
- Këlcyrë
- Libohovë
- Përmet
- Tepelenë

OJF rajonale

- Fondacioni Gjirokastra
- Shoqata "Çajupi"
- Cultural Heritage without Borders (Trashëgimia Kulturore pa kufij)
- CESVI Albania (Agjencia Italiane e Bashkëpunimit për Zhvillim)
- Shoqata për Mjedisin, Ujërat dhe Pyjet
- CIOF

6. Gjendja ekzistuese e mjedisit

Përshkrimi i kuadrit mjedisor dhe social të zonës së projektit bazohet në një kombinim të rishikimit të të dhënave ekzistuese dhe vrojtimeve në terren me objekt të përcaktuar si dhe, përfshirjen dhe angazhimin e palëve të interesit. Studimi i literaturës u plotësua me vrotimet në terren të zhvilluara ndërmjet Majit dhe Shtatorit 2018 në vende të përzgjedhura, përgjatë linjave sizmike, dhe intervistave me palët e interesit. Vrotimet u fokusuan në zonat me ndjeshmëri të identifikuar që në fazën e parë të VNMSSH-së (përcaktimi i çështjeve të VNMSSH) përfshirë ekologjinë, trashëgiminë kulturore, burimet ujore, përdorimin e tokës, turizmin. Në seksionet e mëposhtme është dhënë një vështrim i përgjithshëm mbi gjendjen e mjedisit fizik e social veçanërisht të lidhur me projektin.

Gjendja e mjedisit fizik

Cilësia e ajrit të mjedisit dhe zhurma

Zona e operacioneve të vrotimit sizmik është kryesisht rurale (korridoret sizmikë nuk ndërpresin qytete). Zhvillimi i industrisë në zonën e projektit është i kufizuar e për rrjedhojë cilësia e ajrit në të pritët të jetë kryesisht e mirë. Burimi kryesor i zhurmës është trafiku i automjeteve ndërsa zonat dhe vendbanimet më të ekspozuara janë ato që gjenden përgjatë korridoreve kryesore rrugore që lidhin qytetet e Memaliajt me Tepelenën, Gjirokastrën dhe Libohovën me Këlcyrën dhe Përmetin. Të dhënat e regjistruara gjatë vitit 2017 në qytetin e Gjirokastrës tregojnë tejkalim të niveleve të zhurmës gjatë natës (50.11 dB (A) krahasuar me standartin e OBSH-së 45dB (A)). Gjatë ditës niveli i zhurmës ishte 58.35 dB (A), duke e tejkaluar vlerën kufi të OBSH-së me 6.9%. Nuk ka të dhëna të monitorimit të zhurmës për zonat rurale; gjithsesi, niveli i zhurmës pritët të jetë kryesisht brenda vlerave kufi të lejuara si rezultat i trafikut të kufizuar dhe numrit të pakët të aktiviteteve të tjerë që çlirojnë zhurmë.

Gjeologjia dhe Tokat

Zona e studimit shtrihet në rajonin jugor të Shqipërisë dhe karakterizohet nga prezenca e vargjeve malorë, të ndërtuar nga gëlqerorët, Trebeshinë - Dhëmbel – Nemërçkë, Shëndëlli - Lunxhëri – Bureto dhe Mali i Gjerë-Stugarë, si dhe e luginave. Tiparet më karakteristike të gjeomorfologjisë në zonën e projektit janë shpatet e pjerrët dhe kurrizet e sheshtë të maleve. Formacionet gëlqerore të karstëzuara janë shumë të përhapura në zonën e projektit, veçanërisht në shpatet lindore të maleve. Njëkohësisht gjeologjia e karstit karakterizohet nga sisteme ujore nëntokësore dhe shpella, të cilat gjithashtu janë të pranishme në zonën e projektit. Bazuar në vrotimet në terren, zonat më të prirura ndaj erozionit përfshijnë shpatet kodrinore në territorin e njësisë administrative Luftinjë, veçanërisht sistemin kodrinor të fshatit Zhapokikë. Zona të tjera të prirura ndaj erozionit përfshijnë tokat bujqësore të braktisura përgjatë luginës së lumit Drinos. Monumentet natyrore të mbrojtur për rëndësinë ose vlerat e tyre gjeologjike përfshijnë Pyllin e Ngurtë Ndëran dhe Shpellën e Mezhgoranit (shih Figurën 8). Të dhënat aktuale për sizmicitetin nënvizojnë faktin që pjesa perendimore e zonës së projektit karakterizohet kryesisht nga aktiviteti mikrosizmik, i përqëndruar në 10 km e parë pranë sipërfaqes së tokës, përjashtuar ngjarjet në thellësi më pak se 1 km. Referuar të dhënave historike, zona e projektit përfshihet në territorin e shkallës VII sipas MSK-64, ku mund të ndodhin tërmete me manjitudë maksimale të pritshme ndërmjet 6.0 dhe 6.9. Shkaqet e tërmeteve janë natyrore.


Burimet ujore

Zona e studimit gjendet brenda basenit ujëmbledhës të lumit Vjosa. Lumenjtë kryesorë që ndërpriten nga korridoret sizmikë përfshijnë lumin Vjosa dhe tributarët e tij që janë Drinosi, Suha, Zagoria, Bënça si dhe përroi i Luftinjës. Lumenjtë karakterizohen nga një rrjedhë e çrregullt sezonale e cila arrin maksimumin në vjeshtë dhe dimër dhe reduktohet në verë. Lumenjtë malorë janë të njohur për regjimin e tyre të rrëmbyer dhe përmbytjet periodike. Përmbytjet shkaktohen nga ndryshimet e konsiderueshme të regjimit të reshjeve, veçanërisht gjatë muajve të dimrit, kur sasia e tyre është më e lartë. Në muajt e verës, lumenjtë e vegjël dhe përrrenjtë mund edhe të thahen plotësisht. Të dhënat për cilësinë e ujërave brenda zonës së projektit janë të kufizuara në 3 stacione: 2 prej të cilëve gjenden në lumin kryesor Vjosa dhe një në tributarin e tij, lumin Drinos. Bazuar në rezultatet e monitorimit të përvitshëm të publikuara nga AKM cilësia e ujërave të basenit të Vjosës klasifikohet si e mirë (kategoria e dytë).

Akuiferet porozë dhe karstikë janë burimet kryesorë të ujërave nëntokësore në zonën e studimit, të cilët mbështesin furnizimin me ujë të pijshëm dhe nevojat për ujtitje në komunitetet lokale. Ujërat e akuiferëve të karsteve dalin në formën e burimeve, disa prej të cilëve gjenden në zonën e projektit. Këta burime janë burimi kryesor i ujit të pijshëm për qytetet dhe fshatrat e zonës së projektit. Niveli i ujërave nëntokësore në basenin e Vjosës luhet nga 2m në 16m. Rimbushja (ripërtëritja) më e madhe e tyre ndodh gjatë filtrimit të ujërave

sipërfaqësorë. Disa nga burimet e ujit të pijshëm gjenden në afërsi të korridoreve të vrotimit sizmik, siç tregohet në Figura 7.

Figura 7 Burimet e furnizimit me ujë të pijshëm



Biodiversiteti

Zona e projektit përfshin një terren të shumëllojtë me lugina lumenjsh, zona bujqësore, male, luginën e Drinosit si dhe shpate shkëmbore të pjerrëta. Gjithashtu në zonën e projektit gjenden terrene të gjera pyjore (shkurre, lisa, halorë dhe livadhe malore) si dhe dy parqe, konkretisht Parku Kombëtar i Bredhit të Hotovës dhe Parku Natyror i Zagorisë. Të dy këta parqe përfshijnë terrene të shumëllojshëm me vlera natyrore të veçanta dhe me shqetësim të kufizuar nga aktivitetet e njeriut, duke ofruar kështu habitate të pasqetësura për shumë lloje faunistike. Lumenjtë e Vjosës dhe Drinosit janë korridore ekologjike të rëndësishëm të karakterizuar nga terrene moçalore dhe breglumore.


Brenda zonës së projektit gjenden pyje dhe habitate të listuara në Shtojcën I të Direktivës së BE për Habitatet. Habitatet e Shtojcës I janë habitate me interes (me rëndësi ruajtjeje) për Bashkimin Europian, të cilat paraqesin një gjendje të favorshme për ruajtjen e habitateve natyrore dhe llojeve të florës dhe faunës me rëndësi për Komunitetin. Këto habitate në zonën e projektit janë të pasura në biodiversitet. Në zonën e projektit gjenden lloje të kërcënuar të gjitarëve, zvarranikëve, amfibëve dhe zogjve.

Zonat e Mbrojtura

Zonat e Mbrojtura në zonën e projektit përfshijnë parqe kombëtarë, parqe natyrorë dhe monumente natyre. Monumentet natyrore kanë disa karakteristika të veçanta natyrore si, gjeologjike (shpellat), gjeomorfologjike të tokëformimit si tarracat, pusët e ujit, kanionet, si dhe, ekologjike (pemët dhe pyjet). Korridoret sizmikë prej 500 m dhe zonat buferike prej 200 m ndërpresin katërmbëdhjetë zona të mbrojtura, siç tregohet në Figura 8. Zonat e mbrojtura përfshijnë:

- Parku Kombëtar “Bredhi i Hotovës – Dangëlli” i cili përfshin një zonë të gjerë dhe të larmishme që mbështet një gamë të gjerë llojesh dhe pyjesh të maturuar (propozuar si Zonë e veçantë ruajtjeje);
- Parku Natyror i Zagorisë i cili përfaqëson një habitat natyror me shumëllojshmëri biologjike dhe llojesh me interes ruajtjeje;
- 11 monumente natyre të mbrojtura sipas legjislacionit shqiptar për karakteristikat biologjike, gjeologjike ose hidrogjeologjike.

Figura 8 Zonat e Mbrojtura në zonën e projektit



Mjedisi social

Bashkitë në zonën e projektit

Korridorët sizmikë të propozuar gjenden brenda territorit të shtatë bashkive të qarkut Gjirokastër: Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Këlcyrë, Libohovë, Memaliaj dhe Dropull. Këto shtatë bashki përfshijnë gjashtë qytete: Gjirokastër, Tepelenë, Përmet, Këlcyrë, Memaliaj, dhe Libohovë. Brenda korridoreve sizmikë dhe zonave buferike prej 200 m gjenden një numër vendbanimesh.

Përdorimi i tokës dhe pronësia mbi tokën

Familjet zotërojnë disa parcela toke të shpërndara në zona të ndryshme. Pronësia dhe të drejtat mbi tokën mund të jenë komplekse dhe të diskutueshme në disa zona.

Turizmi

Turizmi përfaqëson një aspekt të rëndësishëm të ekonomisë në zonën e projektit, të ndryshëm nga ekonomia bujqësore tradicionale. Aktivitetet dhe atraksionet turistike janë të përqendruara kryesisht në qytetin e Gjirokastrës për shkak të rëndësisë historike dhe arkeologjike të saj. Periudha kryesore e turizmit në Gjirokastër është nga maji deri në tetor. Koha më e pëlqyer për të vizituar luginën e lumit Vjosa dhe zonën e Përmetit është prill-maj dhe shtator-tetor.

Infrastruktura dhe siguria rrugore

Infrastruktura rrugore nuk është e mirëmbajtur duke përbërë shkak për shqetësime në lidhje me sigurinë rrugore. Rruga kryesore kombëtare Memaliaj – Gjirokastër – Jorgucat ka katër korsit dhe është në kushte të mira. Rruga nacionale nga qyteti i Memaliajt për në Përmet është rrugë e asfaltuar e vjetër, me dy korsit dhe në gjendje të keqe. Rrugët e tjera në zonën e projektit, në zonat rurale, janë të pashtuara (me çakëll) dhe me probleme kalimi veçanërisht në sezonin e lagësht (rrëshqitje, përmbytje).

Punësimi lokal

Zona e projektit ka mundësi punësimi të kufizuara. Burimi kryesor i punësimit janë fermat familjare që përfshijnë dhe mbarështimin e bagëtive. Punësimi në qytete është kryesisht në institucionet shtetërore dhe industrinë e shërbimeve.

Trajtimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotur


Menaxhimi i mbetjeve të ngurta nuk është i përshtatshëm dhe mbetjet hidhen në gropa të hapura ku lihen të shpërbëhen duke çliruar ndotës në mjedis. Zona e projektit nuk ka infrastrukturë të mjaftueshme për depozitimin e mbetjeve dhe landfilli më i afërt, me standartet e duhura të depozitimit, është Bajkaj që gjendet në bashkinë Delvinë.

Në zonën e projektit nuk ka asnjë impiant të trajtimit të ujërave të ndotur. Ujërat e ndotur të patrajtuar shkarkohen direkt në lumenj. Impianti më i afërt i trajtimit të ujërave të ndotur gjendet në qytetin e Sarandës.

Trashëgimia Kulturore

Zona e projektit është e pasur në trashëgimi kulturore. Trashëgimia kulturore në zonën e projektit përfshin zona të mbrojtura dhe trashëgiminë jomateriale. Përveç zonave të mbrojtura (kryesisht monumente), në zonën e projektit ka varreza lokale (varreza komunale) dhe vende të shenja. Në zonën e projektit zhvillohen ngjarje kulturore si Festivali Folklorik i Gjirokastrës. Vendodhja e objekteve të mbrojtur të trashëgimisë kulturore tregohet në Figura 9. Në draft raportin e plotë të VNMSH janë përfshirë edhe objekte të trashëgimisë kulturore të pashallura dhe mbrojtura nga legjislati, por të identifikuar gjatë vrojtimeve në terren.

Figura 9 Monumentet e kulturës në zonën e projektit



7. Vlerësimi i ndikimit dhe Masat zbutëse

Vlerësimi i ndikimit nga aktivitetet e projektit u krye në dy faza. Në fazën e parë u krye vlerësimi i ndikimeve bazuar vetëm në projektin teknik (megjithë masat zbutëse që përfshihen si pjesë e tij). Në fazën e dytë u krye rivlerësimi i ndikimeve duke konsideruar zbatimin e masave zbutëse shtesë. Ndikimet mbetëse janë efektet që mbeten pas zbatimit të masave zbutëse pjesë e projektit teknik dhe atyre shtesë.

Masat zbutëse që parashikohen në vetë projektin teknik janë treguar në Kuadratin 3, më poshtë.

Kuadrati 3

Masat zbutëse kryesore që përfshin projekti teknik

- Aktivitetet e vrojtimit sizmik do të zhvillohen brenda një korridori prej 500 m përgjatë linjës duke krijuar mundësinë të shmangen receptorët e ndjeshëm ndërkohë që lejon të përftohen të dhëna të besueshme.
- Për të mbrojtur monumentet e trashëgimisë kulturore janë miratuar zona buferike prej 200m në të cilat nuk do të kryhen plasje apo dridhje.
- Një zonë buferike apo mbrojtëse prej 50m në të cilën nuk do të kryhen plasje apo dridhje do të zbatohet për monumentet e natyrës me përjashtim të Zhejit dhe Zagorisë.
- Do të zbatohet procedura e gjetjes rastësore të artefakteve arkeologjike duke siguruar që artefaktet të regjistrohen dhe lihen në zonën ku gjenden. Në këto raste do të zbatohet politika e ndalimit të punimeve.
- Në fazën e parë të përvetësimit të të dhënave do të sigurohen standartet e distancës të sigurisë për strukturat duke bërë matjet dhe testimet verifikuese, nëpërmjet aplikimit të metodës të Shpejtësisë së Ngarkesës së Grimcës (Peak Particle Velocity). Zona buferike do të testohet përmes zbatimit të teknikave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave sizmike. Sipas nevojës dhe rezultatit të testimeve paraprake zona buferike mund të zgjerohet aq sa të garantojë sigurinë e duhur për strukturat e ndjeshme.
- Prerja e pemëve me diametër me shumë së 10 cm në lartësinë e gjoksit do të shmanget. Kur është e nevojshme që të pritet bimësi, atëherë do të bëhet në lartësinë 10 cm nga toka duke ruajtur kështu rrënjën dhe nxitur rimbirjen.
- Ekipi i lejeve do të takohet me pronarët e tokës gjatë zbatimit të projektit (përpara dhe mbas përfundimit të aktiviteteve sizmike në secilën linjë). Mbasi të jetë vrojtuar linja sizmike ekipi i lejeve do të verifikojë me pronarin e tokës ndonjë dëm të ndodhur gjatë operacioneve dhe do të negociojë për kompensimin apo do të adresojë ndonjë ankesë të mundshme.
- Zbatimi i kuadrit procedural të SUA-s për Aksesin në Tokë dhe Zhvendosjen si dhe Reagimit e Komunitetit dhe Kompensimit.
- Kontraktorët do të nxitin që kur është e mundur të marrin punëtorë lokalë dhe kjo kërkesë do të përfshihet dhe në dokumentat e tenderit (ndonëse mundësitë për punësim lokal do të jenë të kufizuara për shkak të afatit të shkurtër të zbatimit të projektit dhe nevojës për punëtorë të specializuar).
- Në zona me ndjeshmëri mjedisore, sociale dhe shëndetësore ekipi i punimeve do të transportojë me krahë kabllot dhe gjeofonët deri në zonën e vendosjes së tyre.
- Projekti do të përdorë ekspozitivë jo-toksikë dhe të degradueshëm.
- Të gjithë karburantet dhe kimikatet do të ruhen në kontenerë të izoluar (argjinaturë/barrierë pritëse përçark depozitës) ndërsa furnizimi i automjeteve me karburant do të kryhet në pika të caktuara me sipërfaqe të shtruar dhe të papërshkrueshme. Lubrifikantët do të ruhen në mjedise të izoluar për të mbajtur dhe mos lejuar përhapjen e rrjedhjeve të mundshme.
- Mbetjet nuk do të lihen ose depozitohen në zonën e punimeve dhe përreth saj. Të gjitha mbetjet do të mbledhen dhe transportohen në kamp nga ku një kontraktor i licensuar do t'i transportojë në një impiant të licencuar trajtimi/depozitimi.

Në Tabelën 2 jepet një përmbledhje e vlerësimit të ndikimeve të operacioneve të vrojtimit sizmik ndërsa vlerësimi për fazat e tjera të projektit si mobilizimi, ngritja e infrastrukturës mbështetëse dhe çmobilizimi gjenden të detajuara në draft Raportin e VNMSSH.

Tabela 2: Përmbledhje e Vlerësimit të Ndikimeve gjatë fazës të zbatimit të vrojtimeve sizmike (për vlerësimin e fazave të tjera referohu Draft Raportit të VNMSSH)

Elementët (receptorët) dhe Ndikimet e Mundshme (*)	Rëndësia e ndikimit	
	Ndikimi	Ndikimi i mbetur
5.1 Tokat (Erozioni i tokës, Ngjeshja e tokës, Ndotja e Tokës)	I ulët	I parëndësishëm
5.2 Gjeologjia (Dëmtimi i monumenteve gjeologjike dhe shembja e formacioneve të karstit)	I lartë	Mesatar
5.3 Ujërat nëntokësorë (Dëmtim i cilësisë së ujërave)	I ulët / Mesatar	I parëndësishëm
5.4 Ujërat sipërfaqësorë (Dëmtim i cilësisë të ujërave, ndryshim i morfologjisë dhe qëndrueshmërisë së brigjeve të rrjedhave ujore)	I ulët / Mesatar	I parëndësishëm
5.5 Biodiversiteti (Humbja dhe shqetësimi i habitateve, humbja dhe shqetësimi i llojeve me rëndësi ruajtje, ndotja e habitateve tokësore dhe ujore)	I ulët / Mesatar	I ulët / I parëndësishëm
5.6 Cilësia e ajrit (Përkeqësim i cilësisë së ajrit, Ndryshimet Klimatike (Gazet me Efekt Serë))	Pa ndikim/ I parëndësishëm	Pa ndikim/ I parëndësishëm
5.7 Zhurma dhe dridhjet ** (Bezdisje e komunitetit, shqetësim i ceremonive fetare dhe kulturore)	Mesatar	I parëndësishëm
5.8 Ndryçimi artificial (Bezdisja e komunitetit, humbja e vlerave pamore)	S'ka ndikim	S'ka ndikim
5.9 Mbetjet (Degradim i mjedisit nga mbetjet, ndotja e mjedisit nga mbetjet e rrezikshme dhe jo të rrezikshme)	I ulët	I parëndësishëm
5.10 Receptorët socialë dhe ekonomikë (Përdorimi i tokës brenda kampeve dhe linjave sizmike, strehimi i punëtorëve në hotele dhe bujtina, akomodimi i punëtorëve në kampin bazë dhe ata fushorë, prania e punëtorëve të huaj pranë komuniteteve lokale, përdorimi i ujit, lëvizja e mjeteve dhe automjeteve të projektit, përhapja e sëmundjeve ngjitëse në komunitetet lokale, siguria, kufizimet e hyrjes në tokat bujqësore, shqetësimi i bagëtive, dëmtimi i strukturave nga dridhjet, rënie e pranisë së turistëve, përdorimi dhe transporti i eksplozivit)	Mesatar	I ulët
5.11 Trashëgimia kulturore (Dëmtim i trashëgimisë kulturore dhe monumenteve të kulturës, dëmtimi i zonave arkeologjike, zhurma dhe pengesa pamore për monumentet e trashëgimisë kulturore, festivalet dhe ceremonitë fetare)	Mesatar	I parëndësishëm
5.12 Pejizazhi dhe vlerat pamore (Dëmtim i rrugëve përfshi ato të pa-asfaltuara, prerja e bimësisë, prania e kampeve fushorë, automjeteve, makinerive dhe pajisjeve, mbetjet, përdorimi i ndryçimit artificial)	Mesatar	I ulët

(*) ndikimet e mundshme të projektit janë grupuar sipas receptorit për t'i paraqitur në formë të përmbledhur në këtë tabelë, duke veçuar nga grupimi ndikimin me rëndësinë më të madhe. Për detajet e plota të vlerësimit të ndikimit ju lutemi referohuni dokumentit të Draft Raportit të VNMSSH. (**) ndikimet e dridhjeve në zonat e mbrojtura dhe infrastrukturën e komunitetit janë adresuar në seksionet përkatëse në këtë raport. Masat kryesore zbutëse shtëse janë përmbledhur në fund të secilit prej seksioneve të mëposhtëm

Ndikimet në mjedisin biofizik

Tokat

Ndikimet e mundshme në tokë përfshijnë ndotjen, erozionin dhe ngjeshjen e saj. Toka mund të ndotet si pasojë e derdhjeve aksidentale gjatë transportit dhe përdorimit të karburanteve, furnizimit të mjeteve ose shkarkimit të kimikateve në zonat e shërbimit të mjeteve dhe depozitimit të mbetjeve. Toka mund të ndotet dhe nga mbetjet e eksplozivëve dhe produkteve të ndezjes së tyre.

Erozioni mund të shfaqet në zonat e zhveshura nga bimësia ku ekspozohet tabani i tokës. Aktivitetet në shpatet e pjerrët dhe zonat me toka të paqëndrueshme mund të rezultojnë gjithashtu në erozion. Dëmtimi i rrugëve të pashtruara të aksesit nga përdorimi i makinerive të rënda dhe rritja e trafikut në to rrugë mund të rezultojë në dëmtim të thellë të sipërfaqes së tokës dhe zhvillimin e procesit të gërryerjes dhe erozionit në tokë. Përdorimi i mjeteve të rënda (p.sh kamionët vibrues), veçanërisht në toka të lagura, mund të shkaktojë ngjeshje të tokës. Ngjeshja e tokës mund të ndodhë gjithashtu edhe në zona ku janë parkuar për një kohë të gjatë mjete të rënda (p.sh. në kampe) ose zona me trafik intensiv (njerëz dhe paisje).

Nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të masave të kontrollit të projektit teknik si dhe duke zbatuar masa zbutëse shtesë të gjitha ndikimet e mbetura në tokë gjatë të gjitha fazave janë vlerësuar si të papërfillshme apo të *parëndësishme*.

Gjeologjia

Ndikimet kryesore në gjeologji lidhen me dëmtimin e monumenteve gjeologjike dhe formacioneve të karstit. Dëmtimet në monumentet gjeologjike dhe në formacionet e karstit mund të ndodhin gjatë ngritjes së kampeve fushore si dhe gjatë operacioneve të vrojtimit sizmik (p.sh shpimi i puseve të plasjes dhe përdorimi i kamionëve vibrues). Në zonën e projektit mund të ketë formacione gjeologjike të panjohura dhe miratuara me ndonjë status mbrojtje të tilla si, shfaqje karstike me vlera të veçanta pejzazhere, të cilat vlerësohen me ndjeshmëri mesatare. Tavanet e shpellave mund të gjenden pranë sipërfaqes së tokës dhe ekziston mundësia që gjatë shpimit të puseve të plasjes të dëmtohen. Për këto arsye ato janë vlerësuar me ndjeshmëri të lartë. Përpara fillimit të operacioneve në terren, ekipi i projektit do të kryejë inspektime të zonës për të shmangur dëmet në formacionet e ndjeshme (të brishta) gjeologjike dhe peisazhere.

Të gjitha ndikimet mbetëse në formacionet gjeologjike të pambrojtura, gjatë gjithë fazave të projektit janë vlerësuar si të papërfillshme ose të *parëndësishme*. Ndikimet mbetëse në formacionet gjeologjike të mbrojtura (monumente) vlerësohen si të ulta/të papërfillshme ose të *parëndësishme*. Ndikimet mbetëse në rast të shembjes së formacioneve karstike vlerësohen mesatare në të *rëndësishme*. Për të reduktuar më tej rrezikun e dëmtimit të formacioneve gjeologjike karstike dhe për të zvogëluar rëndësinë e ndikimit mbetës, është duke u kryer punë shtesë për rishikimin e mënyrave ekzistuese të kontrollit.

Ujërat nëntokësorë

Cilësia e ujërave nëntokësore mund të përkeqësohet si rezultat i rrjedhjeve të karburanteve apo kimikateve si dhe produkteve të shpërbërjes së eksplozivëve, të cilat mund të migrojnë në shtresat e akuiferit. Nëse për ujërat e ndotura përdoren sisteme thithëse apo septike (kryesisht në kampet fushorë) atëherë ekziston rreziku që ndotja biologjike të migrojë (lëvizë) drejt akuiferit të zonës.

Nevojat për ujë të projektit do të plotësohen nga furnizues lokalë të cilët mund të përdorin dhe burimet nëntokësore të ujit. Nevojat për ujë në kampe dhe për operacionet mund të çenojnë burimet ujore ekzistuese gjatë stinës së thatë. Ujërat nëntokësorë konsiderohen me ndjeshmëri të lartë sepse janë burimi kryesor i ujit të pijshëm në zonë. Uji i pijshëm në zonë sigurohet nga burimet nëntokësorë dhe burimet natyrale që ushqehen nga ujërat nëntokësorë. Për të zvogëluar rrezikun e ndotjes të ujërave nëntokësorë nga operacionet e projektit janë propozuar masa të posaçme përfshirë Planin e Parandalimit dhe Reagimit ndaj Derdhjeve dhe Planin e Sigurisë së Transportit tokësor (për të shmangur derdhjet ndotëse nga aksidentet e mundshme).

Të gjitha ndikimet mbetëse në ujërat nëntokësore gjatë të gjitha fazave të projektit janë vlerësuar si të papërfillshme apo të *parëndësishme*.

Ujërat sipërfaqësorë

Ndikimet e mundshme në ujërat sipërfaqësore përfshijnë përkeqësimin e cilësisë së ujërave dhe ndryshime të morfologjisë dhe integritetit të shtratit të rrjedhave ujore. Cilësia e ujërave mund të përkeqësohet si pasojë e rrjedhjeve aksidentale të karburantit në vendet e ruajtjes, gjatë transportit dhe furnizimit të automjeteve dhe mjeteve me karburant, moskapjes së lëngjeve dhe llumrave të shpimit si dhe nga rrjedhjet prej sondave të shpimit dhe automjeteve, përfshi kamionët vibrues. Kjo ndotje mund të transportohet në ujërat sipërfaqësore nga shpëlarjet gjatë rënies së reshjeve intensive të shiut. Pastrimi i bimësisë për nevojat e instalimit të kampeve dhe

për operacionet e vrojtimit sizmik e ekspozojnë tokën ndaj erozionit duke shkaktuar shpëlarjen e saj në formën e llumit i cili depozitohet në përrrenjtë dhe lumenjtë më të afërt.

Ndryshimet në morfologjinë dhe integritetin e brigjeve të rrjedhave ujore mund të jenë pasojë e kalimit të automjeteve nëpër këto rrjedha ose ndërtimit të urave të përkohshme. Qëndrueshmëria e brigjeve të lumenjve është e pasigurtë prandaj janë vlerësuar me ndjeshmëri mesatare. Terrenet me shkëmbinj të zhveshur janë më të qëndrueshëm ndaj ndryshimit prandaj janë konsideruar me ndjeshmëri të ulët.

Për të zvogëluar rrezikun e ndotjes apo përkeqësimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore nga operacionet e projektit, janë propozuar masa të ndryshme përfshirë, masa për kontrollin e erozionit, mbajtja e distancave të sigurisë, Plani i Menaxhimit të Mbetjeve, Plani i Parandalimit dhe Reagimit ndaj Derdhjeve dhe Plani i Sigurisë së Transportit tokësor (për të shmangur derdhjet nga aksidentet e mundshme). Nëpërmjet zbatimit të masave të kontrollit dhe masave zbutëse shtesë të gjitha ndikimet mbetëse në cilësinë e ujërave sipërfaqësore në të gjitha fazat e projektit janë vlerësuar si të papërfillshme apo të *parëndësishme*. Ndikimet mbetëse në morfologjinë e shtratit të rrjedhave ujore konsiderohen si të ulëta apo të *parëndësishme*.

Biodiversiteti

Ndikimet e mundshme në biodiversitet mund të lidhen me humbjet ose dëmtimet e habitatit, veçanërisht habitateve të Shtojcës I të Direktivës së BE për Habitatet si dhe habitateve të monumenteve të natyrës; humbjet apo shqetësimet e llojeve me rëndësi ruajtje të cilat lidhen me këto habitate ose varen prej tyre apo, çënohen nga ndotja e mjedisit.

Pastrimi i bimësisë mund të ndikojë tek llojet nëpërmjet humbjes ose dëmtimit të habitatit, duke dëmtuar indirekt llojet që varen nga këto terrene për ushqim, folezim dhe riprodhim (përfshi brejtësit në tokë apo shumimin e shpendëve). Shumë lloje të faunës brenda këtyre habitateve do të largohen përkohësisht nga zonat për shkak të shqetësimit, kështu që do të ndikohen direkt nga lëvizja e automjeteve, pastrimi i bimësisë etj.

Pastrimi i bimësisë mund të ketë një ndikim të veçantë tek fauna duke humbur (zhdukur) terrenet e shumimit të tyre, ndërprerjes së cikleve të jetës dhe mundësisë për t'u ushqyer, sidomos për llojet e brejtësve që rrëmojnë në tokë. Amfibët dhe llojet e lidhura me terrene moçalore mund të ndikohen nëse zhvillohen operacione që thajnë këto terrene ose pellgjet moçalore.

Aktivitetet e zakonshme njerëzore përfshirë, zhurmën dhe dridhjet nga helikopterët, automjetet, makineritë vibruese si dhe shpërthimet e eksplozivëve, mund të rezultojnë me ndikime direkte në faunën e zonës, sidomos nëse përkohësisht me sezonin e shumimit. Zhurma dhe vibrimet mund të shqetësojnë komunitetet e faunës dhe shkaktojnë ngordhjen e llojeve të vogla të faunës që mund të gjendet pranë ose në afërsi të burimit të zhurmës/vibrimit. Aktivitetet e punëtorëve në kampe mund të shkaktojnë braktisjen e foleve dhe zvogëlojnë mundësitë e riprodhimit dhe, nëse shqetësimi nga zhurmat zgjat, kjo do të shkaktojë stres të vazhdueshëm dhe largim të faunës nga zona. Po ashtu prania e fuqisë punëtore nga jashtë zonës së projektit mund të rezultojë në peshkim dhe gjueti të paligjshme.

Vibrimi dhe zhurma mund të shqetësojë, plagosë apo vrasë gjitarët e vegjël gërryes në tokë, zvarranikët apo shpendët që përdorin sipërfaqen e tokës për shumim (fole dhe shtrim vezësh) si dhe mund të ndikojnë në sjelljet e riprodhimit të amfibëve dhe llojeve që lidhen me terrenet e lagura. Shqetësimet mund të shkaktojnë largimin e shpendëve nga habitatet e tyre.

Përdorimi i pajisjeve që vijnë nga jashtë zonës së projektit ose zona ku mund të gjenden lloje pushtuese ose lloje aliene, kanë potencialin që këto lloje ti sjellin në zona të reja, praktikisht në zonën e projektit.

Ekzistojnë edhe rreziqe që lidhen me shkarkimin e ndotësve (të tillë si hidrokarburet) në mjedis ose me shtimin e sedimenteve në rrjedhat ujore, të cilat mund të kenë pasojë në peshqit ose lloje të tjera që lidhen me mjediset ujore, si lundërzat. Habitatet e ligatinave dhe lumenjve mund të ndikohen nga incidente me shkarkim ndotje në terrenet më të larta që mund të përkeqësojnë cilësinë dhe sasinë e ujit në trupat ujore që ndërpriten me linjat sizmike.

Masat e kontrollit dhe ato zbutëse përfshijnë shmangien, zonat buferike për mbrojtjen e habitateve, masat për kontrollin e erozionit, Planin e Menaxhimit të Mbetjeve, Planin e Parandalimit dhe Reagimit ndaj Derdhjeve dhe Planin e Sigurisë së Transportit tokësor (përdorimi i rruigëve egzistuese dhe kufizimi i shpejtësisë për të shmangur aksidentet e mundshme fatale me kafshët). Kështu me zbatimin e masave zbutëse të gjitha ndikimet mbetëse në të gjithë receptorët dhe në të gjithë fazat e projektit vlerësohen si të papërfillshme ose të *parëndësishme*.

Kuadrati 4

Masa zbutëse shtesë

Tokat dhe ujërat nëntokësorë

- Zbatimi i masave të kontrollit për lëvizjet e automjeteve brenda korridorit sizmik.
- Minimizimi i sipërfaqes së pastrimit/prerjes së bimësisë dhe mbulesës së tokës.
- Hartimi dhe zbatimi i Procedurës së Parandalimit të Erozionit të Tokës.
- Krehja mekanike apo manuale kur është e nevojshme të shkruhet toka e ngjeshur në sipërfaqet e shesheve të kampeve.
- Kur kërkohet, pajisjet do t'i kenë të montuara mjetet e kontrollit
- Zbatimi i Planit të Parandalimit dhe Reagimit për Derdhjet në rast të rrjedhjeve apo derdhjeve të ndotjes në mjedis.

Gjeologjia

- Ndërmarrja e një studimi paraprak bazuar në të dhënat ekzistuese për të hartëzuar gjeologjinë nëntokësore në Shpellën e Mezhgoranit, pasuar nga një vizitë në terren për të kuptuar topografinë dhe shtratin gjeologjik të shpellës me qëllim që të shmaget rreziku i shtuar në zonën e sistemit shpellor.
- Përdorimi, kur është e mundur, i dridhjeve si burim energjie që të mos kryhen shpime në tavanin e shpellës (metoda me puse plasës).
- Vendosja e sensorëve me dridhje në strukturat gjeologjike të brishta (ndjeshme), monumentet kulturore dhe natyrore të njohur dhe mbrojtur/dhe të pa shpallur të mbrojtur me akt të veçantë, me qëllim që të njihen karakteristikat e terrenit përpara shpimit të puseve të vrojtimit sizmik.

Ujërat sipërfaqësorë

- Shmangia e pozicionit të linjave sizmike nga ligatinat dhe trupat ujore; për këtë rekomandohet një distancë prej 100m.
- Vendosja e një argjinate të cekët përreth çdo pingu me dhera për të penguar shpëlarjet.
- Kalimi i rrjedhave me këndin e duhur (të drejtë) dhe në brigje të ulta. Kapja e lëngjeve (llumrave) të shpimit gjatë shpimit të puseve; përdorimi i pajsjeve të duhura për mbledhjen e lëngjeve të shpimit.

Biodiversiteti

- Një specialist i biodiversitetit do të shoqërojë ekipin e pastrimit të bimësisë për të siguruar minimizimin e dëmtimit të habitatit.
- Një specialist i biodiversitetit do të kryejë vrojtime për praninë e foleve të shpendëve dhe faunës përpara pastrimit të bimësisë.
- Shmangia e habitateve të ndjeshme dhe zonave të mbrojtura, si dhe habitateve të Shtojcës I, të identifikuar nga specialisti i biodiversitetit
- Ruajtja e shtresave të vegjetacionit dhe mbulesës së tokës, të hequra për nevojat e vrojtimit sizmik, për t'u përdorur për restaurimin e tokës.
- Ruajtja e dherave të hequra të mbuluara për të parandaluar erozionin dhe rritjen e specieve invazive.
- Zbatimi dhe forcimi i ndalimit të gjuetisë dhe peshkimit nga fuqia punëtore e projektit.
- Kryerja me zig zage e punimeve përgjatë korridorit me qëllim që të shmangët prerja e bimësisë.
- Përdorimi si korridor lëvizje përgjatë linjës, i hapsirave natyrisht të zhveshura nga vegjetacioni.
- Larja e automjeteve përpara se të hyjnë në zonën e projektit që të shmangët përhapja e farave dhe bimëve invazive në zonën e projektit.

Ndikimet nga shkarkimet në mjedis të projektit

Cilësia e ajrit

Burimi kryesor i shkarkimeve në ajër do të jenë automjetet dhe gjeneratorët me naftë në kampet fushorë. Si pasojë e operacioneve të transportit dhe rrugëve të pa asfaltuara priten shkarkime në ajër të tilla si, pluhur dhe lëndë e ngurtë. Po kështu, çlirim i pluhurit pritet të ndodhë dhe gjatë pastrimit të bimësisë. Cilësia e ajrit konsiderohet me ndjeshmëri të lartë. Për reduktimin e ndikimeve në cilësinë e ajrit do të zbatohen masa zbutëse të tilla si kontrolli i pluhurit, përdorimi eficient i pajisjeve dhe transportit si dhe, përzgjedhja e teknologjisë së përshtatshme për këtë qëllim. Të gjitha ndikimet mbetëse në cilësinë e ajrit nga operacionet e projektit gjatë të gjitha fazave të zbatimit të tij, përfshi edhe shkarkimet e gazeve me efekt serë dhe ndikimin në ngrohjen globale, janë vlerësuar si të papërfillshme ose të parëndësishme.

Zhurma dhe dridhjet

Automjetet (përfshi edhe helikopterët) do të përshkojnë teritorret e bashkive Gjirokastër, Tepelenë, Këlcyrë, Libohovë, Përmet dhe Memaliaj. Receptorët kryesorë në zonën e projektit janë fshatrat dhe terrenet bujqësore (ku kullosin edhe bagëtitë) me ndjeshmëri mesatare ndaj zhurmës. Ndërsa zonat e pakta me profil industrial janë

më pak të ndjeshme ndaj zhurmës. Duke qënë se pjesa më e madhe e operacioneve të projektit do të kryhet në terrene rurale, ndjeshmëria e receptorit konsiderohet mesatare për çdo rast. Përveç kësaj, në fshatra ose pranë tyre mund të zhvillohen ceremoni fetare dhe kulturore. Në raste të tillë zhurmat dhe dridhjet në zonat rurale vlerësohen si faktor me ndjeshmëri të lartë.

Me zbatimin e masave zbutëse të tilla si, mbajtja e distancës nga receptorët e ndjeshëm, mirëmbajtja e paisjeve që çlirojnë zhurmë dhe zbatimi i Planit të Përfshirjes së Palëve të Interesit (për të kuptuar shqetësimet e komunitetit ndaj zhurmës, bezdisjes dhe aktiviteteve të tjera të projektit), ndikimet mbetëse nga zhurma dhe dridhjet janë vlerësuar si të papërfillshme ose *të parëndësishme*.

Pasojat e dridhjes në objektet natyrore (p.sh monumentet e natyrës) janë përshkruar në seksionin e gjeologjisë ndërsa ndikimet në monumentet e kulturës paraqiten në seksionin e Trashëgimisë Kulturore të këtij raporti.

Ndriçimi artificial

Banorët lokalë mund të bezdisen dhe shqetësohen nga ndriçimi artificial i objekteve të projektit. Receptorët e ndryshëm humanë kanë ndjeshmëri të ndryshme ndaj ndriçimit: njerëzit në zonat rurale, qendrat e banuara dhe qendrat e kujdesit shëndetësor janë më të ndjeshëm ndaj ndriçimit se sa ata në zonat tregtare apo industriale. Megjithëse zonat me karakter industrial si p.sh. Gjirokastra mund të jenë më pak të ndjeshme ndaj ndriçimit artificial, skema e ndriçimit të objekteve të projektit mund të mos përshtatet me modelin ekzistues të ndriçimit gjatë natës. Në të dy rastet ndjeshmëria e receptorëve njerëzorë ndaj ndriçimit është konsideruar mesatare. Përdorimi i ndriçimit artificial sa me minimal dhe miqësor me faunën dhe zbatimi i Planit të Përfshirjes së Palëve të Interesit (për të kuptuar shqetësimet dhe bezdisjen e komunitetit nga ndriçimi dhe aktivitete të tjera të projektit) do të ndihmojë në menaxhimin e ndikimeve. Ndikimet mbetëse janë vlerësuar si të papërfillshme ose *të parëndësishme*.

Mbetjet

Gjatë VNSSH janë identifikuar ndjeshmëritë ndaj prodhimit të mbetjeve dhe menaxhimit të ndikimit që lidhet me to. Bezdisja e shkaktuar nga mbetjet dobëson karakterin e zonës si për banorët ashtu edhe për turistët, prandaj ndjeshmëria ndaj ndikimeve nga mbetjet vlerësohen si mesatare (për receptorët njerëzorë). Mungesa e menaxhimit të duhur të mbetjeve të rrezikshme, të pa rrezikshme ku përfshihen edhe mbetjet shtëpiake, mund të çojë në ndotje të mjedisit. Operacionet e vrojtimit sizmik do të zhvillohen kryesisht në zona rurale që konsiderohen me ndjeshmëri mesatare ndaj ndikimit të mbetjeve. Hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Procedurave të Kujdesit në Punë do të shërbejnë për zbutjen e ndikimeve nga mbetjet e projektit. Të gjitha ndikimet mbetëse nga mbetjet janë vlerësuar si të papërfillshme ose *të parëndësishme*.

Kuadrati 5

Masa zbutëse shtesë

Cilësia e ajrit

- Shmangia e aktiviteteve që çlirojnë pluhur pranë qendrave të banuara.
- Minimizimi i përdorimit të autovejeteve dhe fikja e motorëve të tyre dhe të pajisjeve kur nuk punohet.

Zhurma dhe dridhjet

- Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Udhëtimeve duke minimizuar dhe kontrolluar trafikun, kufizuar orët me aktivitete të zhurmshme në kampet pranë qendrave të banuara si dhe gjatë natës.
- Mirëmbajtja dhe operimi i drejtë i pajisjeve dhe makinerive.
- Reduktimi i shqetësimeve, planifikimi i rrugëve të fluturimeve, kohës dhe lartësisë së duhur për fluturimet e helikopterëve mbi zonat e banuara.

Ndriçimi

- Mbajtja në minimum dhe përzgjedhja e ndriçimit miqësor me mjedisin.

Mbetjet

- Hartimi dhe zbatimi i Planit të Menaxhimit të Mbetjeve dhe Kujdesit të Punës.
- Grumbullimi i mbetjeve në kazanë të mbuluar me qëllim që të mos përhapen nga era.
- Zbatimi i praktikave të higjienës dhe mbajtja pastër nga mbetjet e kampit bazë, atyre fushore dhe zonave të vrojtimit sizmik.
- Identifikimi i materialeve të riciklueshme që mund të dërgohen për përpunim në një impiant të licencuar.

Ndikimet sociale, ekonomike dhe në trashëgiminë kulturore

Sociale dhe Shëndetësore

Ndikimet kryesore sociale dhe shëndetësore janë ato që lidhen me aksesin dhe përdorimin e tokës gjatë zbatimit të aktiviteteve të projektit dhe konkretisht të tokave që përdoren për kultivim apo kullotje. Ndikime të tjera të

natyrës sociale dhe shëndetësore lidhen me aktivitete të tilla si, akomodimi i punëtorëve pranë ose në fshtatrat e zonës, dëmtimi i mundshëm i ndërtesave, shqetësimi nga aktivitetet e vrojtimit sizmik dhe punëtorët, përdorim i tepërt i burimeve ujore të zonës dhe shërbimeve shëndetësore si dhe, rreziqe që lidhen me trafikun gjatë operacioneve të transportit.

Në disa raste aksesit në tokë mund të kërkojë pastrimin e bimësisë nga toka të kultivuara apo kullota. Duke marrë parasysh përdorimin e tokës në zonën e projektit këto nevoja të projektit mund të kenë ndikim në disponibilitetin e ushqimit dhe mënyrën e jetës në familjet e ndikuara.

Në rast se punëtorët do të akomodohen brenda fshatrave kjo do të ndikojë në terma afatshkurtër mënyrën e jetës për banorët, ku ndikimi do të zgjasë për sa kohë punëtorët janë të strehuar në një fshat të caktuar. Kjo situatë mund të përkeqësojë furnizimin me ujë, sistemet e higjienës dhe rrugët që përdoren nga komuniteti. Ndërsa akomodimi i punëtorëve në hotele dhe bujtina mund të ketë ndikim në turizmin e zonës.

Përdorimi i pa përshtatshëm i lëndës plasëse dhe dridhjeve mund të rezultojë me dëmtime të ndërtesave pranë zonës së vrojtimit sizmik apo dhe infrastrukturës. Fluturimet e helikopterëve, çlirimi i energjisë sizmike dhe lëvizjet e njërzëve dhe makinerive, mund të shqetësojnë bagëtitë në zonën e punimeve. Dridhjet e provokuara për përvetësimin e të dhënave sizmike dhe lëvizja e pajisjeve mund të dëmtojnë strukturat përfshi ndërtesat, hangarët dhe rrethimet. Më të ndjeshme ndaj dridhjeve mund të jenë strukturat e vjetra, të pamirëmbajtura dhe ato të nëndheshme të tilla si, burime apo dhe gropat septike. Lëvizjet e pajisjeve dhe automjeteve të projektit mund të shkaktojnë dëmtim të strukturave të tilla si gardhe e rrethime.

Furnizimi me ujë është i kufizuar në shumë zona të projektit kështu që përdorimi i tepruar nga projekti mund të ndikojë në disponibilitetin e ujit për komunitetin. Objektet e shërbimit shëndetësor dhe stafi përkatës janë të kufizuar në zonat rurale kështu që përdorimi i këtij shërbimi edhe nga punëtorët e projektit mund të ndikojë disponibilitetin e tij për komunitetin lokal.

Prania e punëtorëve të projektit dhe trafiku mund të ndikojnë në komunitetin lokal nëpërmjet zhurmës, rritjes së trafikut në rrugë dhe sjelljeve të papërshtatshme si hedhja e mbetjeve në tokë.

Praktikat e Mira Ndërkombëtare të Industrisë dhe qasjet e përshtatshme dhe testuara lokalisht të tilla si, teknikat e shmangies, kompensimi për dëmet, konsultimet në terren dhe zbatimi i kodit të sjelljes, janë propozuar si masa për zbutjen e ndikimeve. Nëpërmjet zbatimit të masave zbutëse të gjitha ndikimet mbetëse sociale dhe në shëndet priten të menaxhohen duke rezultuar të papërfillshme ose të *parëndësishme*.

Trashëgimia kulturore

Aktivitetet e projektit që kanë gjasa të kenë ndikim në trashëgiminë kulturore dhe arkeologjinë lidhen me pastrimin e zonës së punimeve dhe sheshimin e tokës, lëvizjen e pajisjeve dhe automjeteve si dhe përvetësimin e të dhënave sizmike. Përgjatë linjave të përvetësimit sizmik dhe në sipërfaqet e kampeve mund të nevojitet aksesit, pastrimi i bimësisë dhe sheshimi i tokës. Këto operacione mund të ndikojnë në aspektin fizik monumentet e trashëgimisë kulturore dhe sitet ende të panjohura arkeologjike. Përdorimi i lëndës plasëse mund të krijojë dëme fizike në monumentet e kulturës pranë zonës së punimeve. Zhurma dhe zënia e shikimit nga lëvizja e automjeteve të projektit mund të ndërpresë dhe ndikojë në kundrimin e qetë të monumenteve të trashëgimisë kulturore nga turistët dhe banorët vendas. Kjo gjithashtu mund të ndikojë në ceremonitë fetare dhe kulturore që zhvillohen gjatë zbatimit të projektit në terren

Ndikimet e projektit në këtë receptor do të zbuten duke zbatuar masa të tilla si aplikim i zonës buferike/distancave, vlerësim paraprak i strukturave të ndjeshme, konsultimi/sigurimi i udhëzimeve nga specialistët dhe autoritetet lokale të trashëgimisë kulturore për vlerësimimin e ndjeshmërisë. Ndikimet mbetëse në trashëgiminë kulturore do të menaxhohen duke rezultuar nga të ulta në të papërfillshme të *parëndësishme*.

Kuadrati 6

Masa zbutëse shtesë

- Noftimi i pronarëve të tokës për planin e aktiviteteve të vrojtimit sizmik në zonë.
- Nëse pranë zonës së operacioneve të vrojtimit sizmik kullotin tufa bagëtish atëherë do të kontaktohet pronari ose bariu i tyre për të menaxhuar dhe siguruar lëvizjen e sigurtë të bagëtive.
- Zbatimi i Planit të Akomodimit të Punëtorëve me qëllim që të minimizohen ndikimet. Nëse akomodimi/strehimi i punëtorëve do të kryhet nëpër fshatra atëherë do të mbahen konsultime me banorët dhe do të dakordësohet paraprakisht për përdorimin e ndërtesave, ujit të pijshëm, rrugëve dhe sistemit higjieno-sanitar.
- Identifikimi i vendodhjes së ndërtesave dhe objekteve të ndjeshme infrastrukturore; pozicionet e linjave sizmike do të shmangen në distancën e sigurisë përkundrejt këtyre objekteve.
- Sigurimi i shërbimit shëndetësor (objekte dhe staf) për punëtorët e projektit për të reduktuar barrën e shërbimeve mjeksore lokale.
- Trajnimi i punëtorëve të projektit për kodin e sjelljes me komunitetet në zonën e projektit.
- Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Ujit për të reduktuar ndikimet në sistemet e furnizimit me ujë në zonën e projektit.
- Zbatimi i Planit të Menaxhimit të Transportit dhe Planit të Menaxhimit të Trafikut.

Kuadrati 7

Masa zbutëse shtesë

- Të shënohen zonat ku gjenden varrezat dhe zona të njohura të trashëgimisë kulturore pranë kampeve fushorë dhe përgjatë korridoreve sizmike në mënyrë që të shihen lehtësisht dhe shmangen dëmet në këto objekte.
- Diskutimi dhe dakordësimi me drejtues të komunitetit, përfaqësues të objekteve fetare dhe çdo palë tjetër interesi i një distance të përshtatshme shmangie nga zonat e njohura të varrezave dhe shtrirjes së zonave të trashëgimisë kulturore.
- Vlerësimi i qëndrueshmërisë së strukturave përpara ekzekutimit të operacioneve të vrojtimit sizmik, dhe diskutimi i kësaj çështje me palët e prekura apo të interesit.
- Një specialist i kualifikuar dhe me përvojë duhet të udhëzojë projektin lidhur me trashëgiminë kulturore.
- Për të minimizuar ndonjë ndikim të projektit në aktivitetet kulturore duhet që ekipi i menaxhimit të projektit të mbajë kontakt dhe informohet nga bashkitë dhe Ministria e Kulturës për kalendarin dhe programet e këtyre aktiviteteve.

8. Ngjarjet e paplanifikuara

Ngjarjet e paplanifikuara përkufizohen si “ngjarje logjiksht e parashikueshme” që nuk është planifikuar si pjesë e projektit por që mund të ndodhë si rezultat i aktiviteteve të tij (p.sh aksidente). Të tilla ngjarje mund të kenë probabilitet të vogël për të ndodhur. Ngjarjet e paplanifikuara mund të ndodhin në çdo fazë të projektit. Konsideratat për këto ngjarje janë fokusuar kryesisht në dëmtimin e depozitave të karburantit dhe vajit, përplasjeve së automjeteve dhe aksidenteve, shpërthimeve dhe zjarreve të pakontrolluar.

Për menaxhimin e ngjarjeve te pazakonshme janë përcaktuar një numër i konsiderueshëm masash zbutëse. Nëpërmjet zbatimit të Planit të Përgjigjes ndaj Emergjencave dëmet e këtyre ngjarjeve mund të minimizohen dhe vihen nën kontroll. Përveç zbatimit të Praktikave të Mira të Industrisë, ndër masat e përcaktuara përfshihet edhe trajnimi i stafit për reagimin e shpejtë ndaj zjarrit, rrjedhjeve nga incidentet dhe avaritë, dhe parandalimin e aksidenteve. Nuk pritët ndonjë ndikim i rëndësishëm si pasojë e ngjarjeve të paplanifikuara.

9. Ndikimet kumulative

Ndikimet kumulative (të mbledhura) rezultojnë si pasojë e shtimit të ndikimeve të projektit në ndikimet në mjedis të kaluara, të tanishme apo që parashikohen nga aktivitete në të ardhmen, pavarësisht se kush i zbaton këto aktivitete. Ndikimet kumulative janë shumatore e ndikimeve të veçanta dhe të vogla por që të mbledhura së bashku mund të kenë pasojë të rëndësishme në kohë. Gjatë kësaj VNSSH nuk janë identifikuar ndikime kumulative si pasojë e projektit.

10. Ndikimet pozitive

Projekti do të ndikojë pozitivisht përmes punësimit të fuqisë punëtore nga Shqipëria dhe prokurimit të strehimit, mallrave dhe shërbimeve.

Projekti do të angazhojë rreth 190-200 punëtorë nga të cilët 50-60 duhen të specializuar dhe me shumë mundësi do të jenë shtetas të huaj. Për pjesën tjetër të punëtorëve preferenca është për punëtorë vendas. Akomodimi i punëtorëve do të bëhet në kampe, hotele ose në bujtina lokale ose nëpërmjet kombinimit të tre këtyre alternativave. Ndikimet pozitive përfshijnë:

- Qira paguar pronarëve të tokës së përdorur për kampet.
- Rritje e të ardhurave të hoteleve dhe bujtinave nga dhomat e përdorura nga punëtorët e projektit.
- Qira të paguara pronarëve privatë ose autoriteteve lokale për përdorimin e shtëpive ose objekteve të jetesës në komunitet.
- Blerja e mallrave (si ushqimi) dhe shërbime të tjera apo materiale që mund të sigurohen në vend.

Vendimet në lidhje me blerjen e mallrave dhe shërbimeve do të merren nga Kontraktori për rrjedhojë burimet e furnizimit dhe volumet e tyre nuk mund të përfshihen në këtë raport VNSSH. Kontraktori do të përpiqet në mënyrë të arsyeshme të përdorë sa më shumë paisje vendase me kusht që këto paisje të kontraktuara lokalisht të përmbushin standartet shqiptare dhe ato të Shell. Parashikohet që shumë nga mallrat dhe shërbimet (përfshirë disa paisje jo specifike, automjetet, materialet dhe kateringun) të prokurohen në rajon (p.sh. në qarkun e Gjirokastrës) ose brenda vendit. Paisjet e specializuara të sizmikës dhe materialet duhet të sillen në Shqipëri nga jashtë. Prokurimi në fshatrat pranë linjave sizmike pritët të jetë i vogël për shkak të mundësive të kufizuara për mallra dhe shërbime që kanë këto komunitete. Gjatë ditëve të pushimeve dhe udhëtimit për në dhe nga vendi i punës, fuqia punëtore e projektit do të frekuentojë restorante, bare, dyqane dhe shërbime transporti, duke krijuar të ardhura në rritje për këta aktivitete tregtarë.

11. Menaxhimi dhe Monitorimi i Mjedisit

SUA do të sigurohet që në kontratën e zbatimit të projektit në terren, Kontraktori të jetë i detyruar të zbatojë masat zbutëse të përcaktuara në raportin e VNMSH. SUA do të sigurohet që stafi i projektit është trajnuar për të identifikuar ndjeshmëritë dhe zbatuar procedurat e menaxhimit operacional kështu që të gjitha nivelet e stafit do të mund të kontribuojnë në mënyrë efektive për parandalimin e ndikimit dhe zbatimin e masave zbutëse gjatë zbatimit të projektit. SUA do të sigurojë që Kontraktori të jetë në gjendje të përmbushë kërkesat e Deklaratës Mjedisore dhe të zbatojë praktikën e mirë për mjedisin të rekomanduara në VNMSH. SUA do të monitorojë dhe mbikqyrë zbatimin efektiv të masave zbutëse nga Kontraktori.

Zbatimi i Planit të Menaxhimit Social dhe Mjedisor (PMMS) dhe planeve të tjera operacionale do të sigurojnë përputhshmërinë e projektit me standartet kombëtare (dhe ndërkombëtare). Për më tej zbatimi i PMMS do të sigurojë që ndikimet e pritshme të projektit në mjedis të mbeten brenda parashikimeve të bëra gjatë VNMSH. Planet e menaxhimit përmbajnë udhëzime specifike, procese dhe veprime për të arritur zbutjen e ndikimeve të mundshme si pasojë e zbatimit të projektit. SUA do të sigurojë burimet dhe kohën e duhur menaxheriale për të siguruar zbatimin e PMMS dhe planeve specifike. Në Kuadratin 8 pasqyrohet një listë e planeve që do të hartohen nga SUA dhe Kontraktori i sizmikës përpara fillimit të operacioneve të mbledhjes të dhënave sizmike në terren.

Kuadrati 8	Planet e menaxhimit
<ul style="list-style-type: none">• Plan i Aksesit në Tokë, Zhvendosjes dhe Kompensimit• Plani i Akomodimit të Punëtorve• Plani i Menaxhimit të Udhëtimeve• Plani i Menaxhimit të Trafikut• Plan i Sigurisë gjatë Transportit tokësor	<ul style="list-style-type: none">• Plani i Menaxhimit të Ujit• Plani i Menaxhimit të Mbetjeve• Plani i Përballimit të Emergjencave (PPE), përfshi edhe Planin e Parandalimit dhe Reagimit ndaj Derdhjeve.• Plani i Përfshirjes të Palëve të Interesit.

12. Përfundime

Vlerësimi i ndikimeve të mundshme mjedisore dhe sociale të projektit të propozuar të vrojtimit sizmik është kryer duke përdorur qasjen parandaluese dhe konservative, bazuar në të dhëna të publikuara, nëpërmjet mbledhjes të dhënave shtesë në terren, informacionit të mbedhur gjatë konsultimeve si dhe kontributit të kombinuar të eksperteve të AECOM and EMA. Bazuar në këtë proces vlerësimi, masat e propozuara për zbutjen e ndikimeve janë dakordësuar edhe me SUA-n.

Me zbatimin e suksesshëm të masave të kontrollit dhe atyre zbutëse të përfshira dhe koordinuara nëpërmjet planeve të menaxhimit, ndikimet mbetëse të aktiviteteve të propozuara të vrojtimit sizmik, të cilat janë të lëvizshme dhe kalimtare në një periudhë prej rreth 6 muaj, me shumë gjasa do të jenë të ulta dhe të parëndësishme.

Megjithatë, në rast të ngjarjeve të paplanifikuara të tilla si, zjarre, shpërthime apo derdhje në sasi të mëdha të karburanteve, ndikimet në mjedis dhe komunitet mund të jenë të rëndësishme. Nëpërmjet përgatitjes dhe zbatimit të Planit të Përballimit të Emergjencave, SUA do të sigurohet që ndikimet nga situatat e të tilla të paplanifikuara (zjarri, shpërthimet, derdhjet) të parandalohen dhe minimizohen.

Duke marrë në konsideratë natyrën afatshkurtër të projektit dhe zhvillimin e ulët industrial të zonës, zbatimi i aktiviteteve të propozuara të vrojtimit sizmik nuk ka ndikime kumulative.

